



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-053

Prishtinë, më 24 shkurt 2016, në orën 16:40

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 24 SHKURT 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Slobodan Petroviq dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Albin Kurti, Time Kadrijaj, Slavko Simiq, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi dhe Avni Bytyçi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati dhe

Nga KDI-ja: Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari procedoi me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i kërkesës për seancë së jashtëzakonshme të Kuvendit

Kryetari i njoftoi të pranishmit me përmbajtjen e shkresës së grupit prej 43 deputetëve të Kuvendit, të cilët kishin parashtruar kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit, më 26 shkurt 2016, në orën 11:00, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Ai tha se në bazë të nenit 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi mbledhet në seancë të jashtëzakonshme me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit ose të 1/3 të deputetëve.

Kryetari theksoi se kërkesës i janë bashkëngjitur dy propozime për nominimin e kandidatëve për President të Kosovës dhe atë: z. Hashim Thaçi dhe z. Rafet Rama.

Pastaj, kryetari i hapi diskutimet lidhur me kërkesën e lartpërmendur.

Lidhur me kërkesën e lartshënuar diskutuan: Valdete Bajrami, Albin Kurti dhe Time Kadrijaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Gjatë zhvillimit të diskutimeve, nënkryetarja e Kuvendit, Aida Dërguti, hodhi gaz lotsjellës në sallën C-301, në të cilën mbahej mbledhja. Për shkak të pamundësisë për të vazhduar, kryetari e ndërpreu mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit u mbajt në sallën N-303

Përfaqësuesit nga grupet parlamentare të opozitës nuk ishin të pranishëm në këtë pjesë të mbledhjes së Kryesisë.

Kryetari procedoi me kërkesën e grupit prej 43 deputetëve të Kuvendit për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit.

Për kërkesën e lartshënuar diskutuan: Adem Grabovci, Xhavit Haliti dhe Slavko Simiq, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të pranishëm në mbledhje, vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet më 26 shkurt 2016, në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 17:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale